



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr. 450 prot

Roskovec , më 23.01.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. 3 datë 23/01/2026

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË
TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE, NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI 6%
PËR BLOK-NDIHMËN PËR VITIN 2026**

Në mbështetje ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “ Për vetë qeverisjen vendore”, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Nenit 21 të Ligjit nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 1, të Kreut IV të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”i ndryshuar.

Spektori i ndihmës ekonomike ju paraqet për diskutim dhe miratim Këshillit të Bashkisë Roskovec, kriteret e mëposhtme për trajtimin e familjeve që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit, për vitin 2026.

- Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike brënda tre muajëve të fundit dhe nuk janë përzgjedhur fituese nga sistemi i pikëzimit.
- Familjet të cilat përzgjidhen për tu trajtuar me këtë fond duhet të jenë verifikuar paraprakisht nga zyra e ndihmës ekonomike.
- Familjet e përzgjedhura duhet të jenë familje në nevojë , të jenë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.

- Familjet ku kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për punë por për shkak të legjislacionit në fuqi nuk përfitojnë pagesën e paaftësisë.
- Familjet me prindër të divorcuar me të paktën një fëmijë në arsimin bazë ose të lartë.
- Familjet me kryefamiljar vajzat nëna dhe gratë e veja.
- Familjet të cilat nuk kanë anëtar përfitues të pensionit të pleqëris.

Pas miratimit nga Këshilli i Bashkisë Roskovec, ngarkohet sektori i Shërbimit Social për ekzekutimin e këtij vendimi.

Konceptoi. *E. Kola*
 Miratoi. *S. Çepele*
 Konfirmoi. *M. Goga*
 Për Drejtorinë Juridike . *V. Zeqo*

KRYETARI
Majlinda Buqi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr. 450/1 prot

Roskovec , më 23.01.2026

Relacion: Për miratimin e familjeve në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri 6% për bllok-ndihmën e vitit 2026

KËSHILLIT TË BASHKISË

Roskovec

Të nderuar Këshilltarë.

Në mbështetje të nenit 21 të Ligjit nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Bashkiak, miraton kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik, të kryer nga administrator shoqëror. Familjet në nevojë trajtohen nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike , duke përfshirë ose jo edhe fonde të buxhetit vendor. Përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në pikën 1, të kreut IV të Vendimit nr.597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Këshilli Bashkiak miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për ndihmë ekonomike të cilat nuk janë shpallur fituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike

Spektori i ndihmës ekonomike ju paraqet për diskutim dhe miratim Projekt-Vendimin, “Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri 6% për bllok-ndihmën për vitin 2026” me kriteret e mëposhtme, për trajtimin e familjeve që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit për vitin 2026.

- Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike brënda tre muajëve të fundit dhe nuk janë përzgjedhur fituese nga sistemi i pikëzimit.

- Familjet të cilat përzgjidhen për tu trajtuar me këtë fond duhet të jenë verifikuar paraprakisht nga zyra e ndihmës ekonomike.
- Familjet e përzgjedhura duhet të jenë familje në nevojë , të jenë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
- Familjet ku kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për punë por për shkak të legjislacionit në fuqi nuk përfitojnë pagesën e paaftësisë.
- Familjet me prindër të divorcuar me të paktën një fëmijë në arsimin bazë ose të lartë.
- Familjet me kryefamiljar vajzat nëna dhe gratë e veja.
- Familjet të cilat nuk kanë anëtar përfitues të pensionit të pleqëris.

Këto kritere do i shërbejnë adiminatorëve social të Bashkisë Roskovec, për të përzgjedhur famijet më në nevojë, të cilat kanë aplikuar dhe nuk janë shpallur fituese nga sistemi i pikëzimit, për ti propozuar për trajtim nga fondi i kushtëzuar deri 6%, dhe do të miratohen nga Këshilli i Bashkisë Roskovec çdo muaj.

Konceptoi.E.Kola



Miratoi.S.Çepele



KRYETARI
Majlinda Bufi

